



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2022:014841

Datë: 29.01.2024

Numri i dokumentit: 05254849

**C.nr.79/2022**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin individual Genc Hasani, në çështjen juridike kontestimore të paditëses: F.S. nga M., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Sheremet Ademi dhe Leutrim Ademi avokat me seli në Mitrovicë, kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës-Drejtoria Komunale e Arsimit të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Arbnor Murturi avokat ne Prishtinë, lidhur me çështjen kontestuese kompensim i ushqimit (shujtës ditore) vlera e kontestit 380 euro, jashtë seance me datë 29.01.2024 nxjerr këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. REFUZOHET** ne tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditëses me te cilën ka kërkuar qe te **OBLIGOHET** e paditura Komuna e Mitrovicës Jugore-Drejtoria Komunale e Arsimit, qe ne emër te kompensimit te shujtës ushqimore te parapare me Kontratën Kolektive te Arsimit ne Kosove, paditësit t’ia paguaj shumen prej 380 €, me kamate ligjore prej 8%, nga dita e ushtrimit te padisë e gjere ne pagesën përfundimtare.
- II. DETYROHET** paditësja F.S. nga M.,me nr. personal ....., qe te paditurës Komuna e Mitrovicës Jugore – Drejtoria Komunale e Arsimit, t’i paguaj shpenzimet e procedurës ne emër te përpilimit te përgjigjes ne padi ne vlere prej 78.00 € në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit.

**A r s y e t i m**

Paditësja përmes të autorizuarit të saj, pranë kësaj gjykate, me datë 25.01.2022, kanë parashtruar padi kundër të paditurës, me objekt kontesti për kompensim për ushqim gjatë punës. Tutje ne precizimin e padisë i njëjti ka theksuar se paditëses për periudhën kohore prej 18.04.2017 e deri me 26.03.2018 nuk i është bërë kompensimi për ushqim(shujte-ditore ne shumen prej 2 euro) për 190 dite pune, nga 2 euro për dite pune, shumen prej 380 €, me kamate ligjore prej 8%, nga dita e ushtrimit te padisë e gjere ne pagesën përfundimtare, edhe pse janë plotësuar kushtet e përcaktuara me Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë.

Gjykata, pas shqyrtimit paraprakë të padisë ka nxjerr aktvendim për përgjigje në padi C.nr.79/2022 të datës 02.12.2023, duke e paralajmëruar edhe me pasojat procedurale se nëse nuk parqet përgjigje në padi në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit të lartpërmendur, gjykata do të merr aktgjykim në bazë të pa dëgjueshmërisë / mosbindjes.

E paditua aktvendimin e lartcekur e ka pranuar me datë 11.12.2023 (e cila është konfirmuar përmes fletë kthesës, e cila gjendet në shkresat e lëndës), e njëjta me datën 26.12.2023 ka paraqitur përgjigje në padi dhe ka theksuar meqenëse padia është paraqitur me date 25.01.2022, ndërsa Paditësja kërkon kompensimin për kërkesat të cilat i takojnë periudhës kohore nga data 18.04.2017 deri me date 26.03.2018, mund të konkludohet se kërkesat e paditëses janë parashkruar plotësisht në baze të nenit 87 të Ligjit të Punës i cili përcakton që *“Te gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës.”*

Me rastin e pranimit të përgjigjes në padi, gjegjësisht vlerësimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse e në lidhshmëri me vlerësimin e provave të bashkangjitura, kjo Gjykatë erdhi në përfundim se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, rrjedhimisht nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e një vendimi meritator pa caktuar fare seancë gjyqësore në kuptim të dispozitës nga neni 399 par.1 të LPK-së, e cila përcakton: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritator me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia.”*

Nga provat e bashkangjitura në padi, Gjykata konstatoi se paditësja F.S. nga M., është në marrëdhënie pune tek e paditura, gjegjësisht është e punësuar në vendin e punës si mësimdhënës në SHFMU “E. Ç.” në M.. Po ashtu, u vërtetua se përgjatë periudhës kohore 18.04.2017 deri me datë 26.03.2018, paditësja ka qenë prezentë në vendin e punës për 190 ditë pune. Faktet e tilla vërtetohen në bazë të vërtetimit për ditët e pranisë në punë nr-prot.1968/2021, të dt.23.12.2021, të lëshuar nga Shkolla Fillore e Mesme e Ulët “E. Ç.” në M. Provave materiale të lartcekura, Gjykata ua fali besimin e plotë në kuptim të dispozitës nga neni 329 par.1 të LPK-së, e cila përcakton se: *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të.”*

Lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë, gjykata ka refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses pasi që, Gjykata vlerëson se sa i përket periudhës kohore prej 18.04.2017 e deri me 26.03.2018 gjithsej për 190 ditë pune apo shumen prej 380 euro e njëjta kërkesë është parashkruar duke u mbështetur në nenin 87 të ligjit të punës përcaktohet *“të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri vitesh nga dita e paraqitjes së kërkesës”* meqenëse paditësja ka paraqitur padi me datën 25.01.2022 periudha e lartcekur është parashkruar pasi që ka kaluar afati prej 3 vitesh kur paditësja ka pasur të drejtë të kërkojë

kompensimin ne emër te shujtës ushqimore, andaj ne baze te kësaj gjykata ka vendosur si ne piken I te dispozitivit te këtij aktgjykimi.

Gjykata në mbështetje te nenit 452 të LPK-së vendosi si në piken II te dispozitivit, ashtu që e detyroj paditësen qe ne emër te shpenzimeve procedurale të paguaj shpenzimet e procedurës dhe atë për përpilimin e përgjigjes ne padi nga e paditura në shumë prej 78.00€ - sipas tarifës së OAK.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, e ne mbështetje te nënti 399 dhe 452 te LPK, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË**  
**Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil**  
**C.nr.79/2022, datë 29.01.2024**

**Gjyqtari**  
**Genc Hasani**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së te njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.